
IMPACTS OF COVID-19 ON EDUCATION, CHALLENGES RELATED TO DISTANCE LEARNING (ON-LINE) AND ADVANCEMENT IN THE QUALITY OF EDUCATION

Ramadan Beqiri

College “Biznesi”-Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abetare Kabashi

College “Biznesi”-Prishtina, Kosovo

Abstract: The spread of the Covid-19 virus, quickly took almost the entire globe, being considered as pandemic, which defied all layers such as states, health professions and even educational ones. The well-known Covid-19 pandemic in Kosovo officially appears with the first cases in early March 2020. Apart from other institutions which were closed almost immediately, educational institutions of all levels of the Republic of Kosovo did not escape from this. The challenge in education was related to the way of continuing education, in order to conclude the school year 2019/20. Although sufficient unprepared, the Ministry of Education with difficulty started organizing distance learning (online), through video recordings which it broadcast on public television RTK. For the advancement in the quality of education at all levels in the Republic of Kosovo, it was a period of summer holidays which due to the downfall of the Government elected by the people in 2019, a majority is camouflaged which brought incompetent people to the Ministry of Education, who did not work professionally to get prepared for advanced and qualitative education in the beginning of a new school year (2020/21). In these circumstances teachers found themselves faced with an unimaginable challenge of distance learning. Parents were anxious about providing conditions for their children to attend lessons from home, while pupils and students of all levels were going through one of the challenges that will affect their educational development, for their lifelong careers. During the research were included (n = 15) teachers, distributed in (n = 10) municipalities of the Republic of Kosovo. According to the findings of this study, the new circumstances created after the spread of Covid-19, including changes in education, have caused a number of concerns among students, parents and teachers in Kosovo. Findings from the study confirm the common concerns of the two reporting groups in the study, in relation to student assessment, concerns and overload, as well as assessments of the inadequacy of the teaching conducted so far. The findings of this study confirm the willingness and motivation of teachers to advance their knowledge and skills, and to contribute in the advancement of the education quality.

Keywords: Covid-19, online learning, information technology, teachers, students, parents.

NDIKIMET E COVID-19 NË ARSIM, SFIDAT E NDËRLIDHURA ME MËSIMIN NË DISTANCË (ONLINE) DHE AVANCIMI NË CILËSINË E ARSIMIT

Ramadan Beqiri

Kolegji “Biznesi” Prishtinë, Republika e Kosovës

Abetare Kabashi

Kolegji “Biznesi” Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbledhja: Përhapja e virusit Covid-19, shumë shpejt mori pothuajse tërë globin, duke u cilësuar si pandemi, e cila sfidoi të gjitha shtresat, shtetet, profesionet shëndetësore e madje edhe ato arsimore. Pandemia e njohur Covid-19, në Kosovë zyrtarisht paraqitet me rastet e para në fillim të marsit të vitit 2020. Përveç institucioneve tjera të cilat pothuajse menjëherë u mbyllën, nga kjo nuk shpëtojnë as institucionet arsimore të të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës. Sfida në arsim ishte e ndërlidhur me mënyrën e vazhimit të mësimin, në mënyrë që të përmbylej viti shkollor 2019/20. Edhe pse të papërgatitur mjaftueshëm, Ministria e Arsimit me vështirësi filloi organizimin e mësimin nga distanca (online), nëpërmjet video incizimeve të cilat i transmetoi në televizionin publik RTK. Për avancimin në cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet në Republikën e Kosovës, ishte një periudhë e pushimeve verore e cila për shkak të rënies së Qeverisë së zgjedhur nga populli në vitin 2019, kamuflohet një mazhurancë e cila sjell njerzë jokompetentë edhe në Ministrinë e Arsimit, që nuk punoi me profesionalizëm për të përgatit një fillim viti të ri shkollor (2020/21) të avancuar dhe cilësor në arsim. Në këto rrethana mësimdhënësit u gjetën para një sfide të pa imagjinuar të mësimdhënies nga distanca. Prindërit ishin në ankth për ofrimin e kushteve për fëmijët e tyre që të ndjekin mësimet nga shtëpia, ndërsa nxënësit dhe studentët e të gjitha niveleve po kalonin një nga sfidat të cilat do të ndikojnë në ngritjen e tyre edukativo-arsimore, për karrierën e tyre gjatë gjithë jetës. Gjatë hulumtimit janë përfshirë (n=15) mësimdhënës, të shpërndarë në (n=10) komuna të Republikës së Kosovës. Sipas të gjeturave nga ky studim,

rrethanat e reja të krijuara pas përhapjes së Covid-19, përfshirë ndryshimet në arsim, kanë shkaktuar një sërë shqetësimesh tek nxënësit, prindërit dhe mësimit në Kosovë. Gjetjet nga studimi konfirmojnë brengat e përbashkëta nga dy grupet raportuese në studim, në raport me vlerësimin e nxënësve, shqetësimet dhe mbingarkesën, si dhe vlerësimet për mospërshtatshmërinë e mësimit të realizuar deri më tani. Të gjeturat e këtij studimi konfirmojnë gatishmërinë dhe motivimin e mësimit nënxënësve për të avancuar njohuritë dhe shkathësitë e tyre, dhe për të kontribuar në avancimin e cilësisë së arsimit.

Fjalë kyçe: Covid-19, mësimi online, teknologjia informative, mësimit nënxënësit, nxënësit, prindëritë.

1. HYRJE

Më shumë se 1 miliard e 575 milion nxënës dhe studentë në rreth 188 shtete të botës janë raportuar të jenë ndikuar nga mbyllja e shkollave dhe universiteteve për shkak të masave parandaluese të ndërmarra nga shtetet kundër përhapjes së COVID-19 (Unesco, 2020).

Sfidë për mësimit nënxënësit se si do t'i përcjellin mësimit e tyre deri te nxënësit në njërin anë dhe përveç frigës së prindërve të ruajnë shëndetin e fëmijëve ishte edhe gatishmëria për t'ju ofruar kushte atyre për nxënie të mësimeve nga mësimit nënxënësitë e tyre, në anën tjetër. Në këtë aspekt më të prekurit do të jenë nxënësit dhe studentët të cilët do ta vuajnë gjatë gjithë jetës ngecjen nga nxëniet e njohurive të reja.

Obligimi i mësimit nënxënësve për të qenë në krye të detyrës tani ishte pamundësuar nga vendimet e qeverive të ndryshme për masa kufizuese në lëvizje e madje edhe mbyllje të institucioneve arsimore. Po këtë fat e gjenë edhe Republikën e Kosovës, ku në mars të vitit 2020, mbyll të gjitha institucionet arsimore publike dhe private. Edhe pse ishte periudha e fundit e vitit shkollor, ajo ende nuk mund të shfaqej e përmbyllur ngase kishin mbetur muaj të tërë deri në finish. Ndonëse jo edhe shumë të përgratitur, edhe përkundër trajnive të shumta të mbajtura që nga paslufta e vitit 1999, të vetmen alternative e kishin mësimit nga distanca. Përzgjedhja e mësimit nënxënësve në nivel vendi, u bë në shpejtësi, ku fillojnë me mësime nëpërmjet video-incizimeve, të publikuara në televizionin publik-RTK. Në anën tjetër disa institucione të pavarura arsimore, kishin filluar më heret me përgatitje të platformave të mësimit online, si: www.almooc.com, www.gjeniu.org, etj. Ato kishin kaluar një periudhë që po mbanin mësime nga lëndë dhe nivele të ndryshme nga distanca me një kuadër të përgatitur dhe të përzgjedhur me konkurse publike dhe intervista të gjata e përzgjedhje profesionale. Mirëpo ngritja e cilësisë në arsim përmes të nxëniet nga distanca/online, është një nga sfidat e këtyre viteve. Nga të gjeturat e bëra në disa hulumtime tona e të publikuara rezultojnë se në ato platforma ka një arritje e të nxëniet edhe nga distanca/online.

2. PËRSHKRIMI

Përcjellja e diturisë nga brezi në brez ka bërë që shoqëria të ngritet gjithnjë e më shumë në aspektin edukativo-arsimor. Jemi të vetëdijshëm se vende të ndryshme kanë qenë dhe madje shumë prej tyre edhe vazhdojnë të jenë të persekutuar nga e drejta e të nxëniet të mirëfilltë nga pushtuesit apo edhe nga regjimet e veta totalitare. Një fat të tillë e ka përjetuar edhe Kosova, një vend që padrejtësisht, ishte ndarë nga trangu i saj kombëtar, madje duke ju bashkangjitur, pa villnetin e saj, një federate të krijuar artificialisht – Jugosllavisë, e cila përfundimisht shpërbëhet me luftra ndërmjet republikave të saj, e në fund edhe në vitin 1999, shkëputja e Kosovës nga Serbia, bënë që në trojet tona të kemi pavarësinë e kushtëzuar. Arsimit në Republikën e Kosovës edhe pse nuk mbikqyret dhe sundohet nga okupatori shekullor, nuk solli elitën më të mirë të arsimit në krye të saj. Përvojat kanë treguar se edhe përkundër investimeve të mëdha të bëra në fushën e arsimit, nuk është arritur që të kemi mësimit nënxënës të përgatitur për epokën e re (të nxëniet nga distanca) e cila edhe ashtu po vinte, si rezultat i zhvillimit të hovshëm të teknologjisë informative (TI). Para se të arrihte natyrshëm koha e përballjes me e-mësimit, befas shfaqet virus gjithëpërfshirës në vitin 2019, i pagëzuar si Covid-19. Me arsyetimin se u zumë të papërgatitur, stagnon përnjëherë gjithçka në mësimit nënxënës. Formë e vetme ishte fillimi i të nxëniet nga distanca/online, ngase nxënësit dhe studentët po kalonin kohën më të rëndë të jetës së tyre në aspektin e shkollimit. Tani interesimi, shqetësimi, friga dhe sfida po përfshijnë komunitetin: mësimit nënxënës-prindër-nxënësit. Secili nga përgjegjësit e tij mundohet të bëjë të pamundëren për të mbajtur cilësinë e të nxëniet tradicional.

Edhe viti shkollor 2020/21, filloi me prezencën e Covid-19, në Kosovë, si edhe në pothuajse të gjitha vendet tjera. Ministria e Arsimit (e rrembyer nga fituesi i zgjedhjeve në tetor të vitit 2019), nuk arriti të përgatit platformë unike për mësimit nënxënës, nxënie dhe vlerësim, nga distanca. Ajo nuk mbledhi krerët profesionistë të Arsimit të vendit për të bërë një Strategji profesionale, unike dhe të mirëfilltë kombëtare për një arsimim të drejtë dhe profesional nga distanca/online. Në shumë shkolla ka mbyllje të tyre për shkak të paraqitjes së rasteve të mësimit nënxënësve dhe nxënësve, me Covid-19. Në raste të tilla, sikur ngushëllohen me vazhdim të punës së mësimit nënxënës me anë të video-incizimeve e të shfaqura në televizionin publik-RTK. Në asnjë platformë digjitale, nxënësit apo studentët nuk mund të gjejnë ato mësime një herë tjetër për t'i përcjell, në ndonjë kanal interneti. Kjo ndonëse është për shkak të shfrytëzimit të materialeve të lansuara në platformë të ndryshme si www.youtube.com, www.almooc.com,

www.gjeniu.org, etj. Ato vlerësojnë plagjiaturë, ritransmetimin e një pjese apo tërë materialit në rrjete tjera apo kanale tjera.

3. QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PUNIMIT

Sidoqoftë, të nxënit nga distanca apo online, mund të konsiderohet sfidë e mësimdhënies dhe nxënies në Kosovë. Poashtu mund të supozohet se kjo mënyrë e të nxënit ka shkaktuar ngecje marrë para sysh nivelin jo të kënaqshëm të përgatitjes së mësimdhënësve me teknologjitë e reja informative. Megjithatë, akoma nuk kemi hasur në ndonjë hulumtim apo raport i cili nxjerr të metat apo ngecjet në realizimin e plotë të objektivave mësimore që nga shfaqja e virusit Covid-19. Prandaj qëllimi i këtij punimi është të hetoj ndikimet e Covid-19 në arsim, sfidat e ndërlydhura me mësimin në distancë (online) dhe avancimi në cilësinë e arsimit, nëpërmjet pyetësorëve për mësimdhënës. Të gjeturat nga ky studim prezantohen të mësimdhënësit dhe prindërit, që shfaqin faktorët me ndikim në cilësinë e sistemeve arsimore duke përdorur teknologjitë informative ashtu siq parashihet nga ekspertët e arsimit gjithandej botës së civilizuar, duke inkorporuar strategji të reja në arsimin Kosovar dhe organizimin e mëtutjeshëm të mësimi online, në mënyrë që nxënësit dhe studentët të mos ngecin në nxënien e diturive të reja. Prandaj, të gjeturat e këtij punimi mund t'u shërbejnë politikbërësve, udhëheqësve arsmior në nivel lokal dhe qëndror, mësimdhënësve dhe të gjithë atyre që kanë për synim të nxënit në çfarëdo kohe e rrethanash. Për më shumë, të gjeturat nga ky studim mund të shërbejnë si pikënisje e studimeve të radhës, përmes të cilave mund të ndihmohen sistemet arsimore, në veçanti ato të vendeve me zhvillim të ulët dhe mesatar ekonomik, në kuadër të të cilave hyn edhe Kosova, për tejkalimin e vështirësive në reformimin e sistemeve të edukimit.

4. METODOLOGJIA

4.1. Qasja e hulumtimit

Për këtë studim është përdorur dizajni hulumtues kualitativ. Në kuadër të qëllimit të studimit është synuar të eksplorohej perspektivat e pjesëmarrësve në raport me temën e trajtuar në hollësi, prandaj është përdorur strategjia e studimeve të rasteve. Studimet e rasteve të konsideruara si një formë mjaft e popullarizuar për të aplikuar hulumtimet kualitative mundësojnë që përmes një rasti ose krahasimit të disa rasteve të eksplorohej në hollësi një situatë ose një ngjarje e veçantë (Almutari, 2009). Gjithashtu, qëllimi i përdorimit të rasteve të studimit nuk është konstruktimi i teorisë për një fenomen specifik, por ekzaminimi i hollësishëm i një fenomeni ose i ngjarjeve (Stake, 1994, në Almutari, 2009).

4.2. Qëllimi i studimit dhe fushat e eksploruara

Qëllimi i këtij studimi është që të eksplorojë dhe përshkruajë shqetësimet e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve të ndërlydhura me rrethanat e shkaktuara për shkak të izolimit social dhe perspektivën e mësimdhënësve dhe të prindërve për mësimin në distancë ose online.

4.3. Pjesëmarrësit dhe procedura

Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësorët, N=15 mësimdhënës. Në studim, të drejtë pjesëmarrjeje kanë pasur të gjithë mësimdhënësit të cilët aktualisht janë në procesin edukativo-arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar publik, klasave 1-9, në qytetet e ndryshme të Kosovës. Përgjatë kontaktimit, pjesëmarrësit janë informuar për qëllimin e studimit dhe që pjesëmarrja e tyre është vullnetare dhe se mund të tërhiqen nga procesi në çdo kohë. Për më shumë, për të mbrojtur konfidencialitetin e tyre, të gjitha të dhënat, përmes të cilave është supozuar se mund të identifikohen, janë larguar përgjatë procesit të përpunimit të të dhënave dhe strukturimit të të dhënave në formatin e rasteve të studimit. Procesi i mbledhjes së të dhënave ka zgjatur nga data 20 tetor deri më 1 nëntor 2020.

4.4. Karakteristikat e pjesëmarrësve

Pjesëmarrës në këtë studim ishin (n=15) mësimdhënës.

Mësimdhënësit pjesëmarrës në këtë hulumtim janë gjithsej (n=15) prej të cilëve (n=9) gra dhe (n=6) burra. Moshë mesatare e tyre është 41.6 vjeç. Numri më i madh i pjesëmarrësve ka të përfunduar nivelin Bachelor të edukimit (n=11), mesatarisht kanë (15.4) vite përvojë pune në mësimdhënie, ndërsa numri mesatar i nxënësve në klasët e këtyre mësimdhënësve, është (20.4) (*shih tabelën 1*).

Tabela 1. Struktura e pjesëmarrësve - Mësimdhënësit

	n	%
Gjinia		
Gra	9	60.00
Burra	6	40.00
Niveli i edukimit		
Shkolla e lartë	1	06.67
Niveli Bachelor	9	60.00
Niveli Master	5	33.33
Mesatarja e nxënësve në klasë		
N		15
Mesatarja		20.4
Vitet e përvojës së punës si mësimdhënës		
N		15
Mesatarja		15.4
Mosha		
N		15
Mesatarja		41.6

4.5. Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrësve

Mësimdhënësit pjesëmarrës janë aktualisht të angazhuar në institucionet parauniversitare publike, klasat 6-9, në qytete të ndryshme të Kosovës: (n=8) në Prishtinë dhe të tjerët janë (n=2) nga Fushë Kosova, (n=1) Podujeva, (n=1) Ferizaj, (n=2) Prizreni, dhe (n=1) Vushtrria (*shih tabelën 2*).

Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrësve

Mësimdhënësit	
Komuna	N (15)
Prishtinë	6
Ferizaj	3
Suharekë	2
Gjilan	1
Istog	1
Pejë	2

4.6. Gjetjet

Pas mbledhjes së pyetësorëve, ato janë analizuar dhe përpunuar veç e veç. Përpos përshkrimit narrativ të bërë, rezultatet janë paraqitur edhe në formë tabelare dhe me grafikone, duke dhënë edhe përqindjet.

Pyetja për mësimdhënës, që u është dhënë për sa i përket përdorimit të teknologjisë informative, para shfaqjes së pandemisë Covid-19, ishte:


1) Sa e keni përdor teknologjinë informative në realizimin e orës mësimore para pandemisë Covid-19?

Tabela 3. Përdorimi i TI para pandemisë

a)	pak	8	53.33%
b)	ndonjëherë	4	26.67%
c)	vetëm për plan-programe dhe teste	2	13.33%
ç)	kam mbajtë edhe mësim nga distanca	1	06.67%

Shumica e mësimdhënësve kanë zgjedhur opcionin e parë (53.33%), tabela 3 dhe grafikoni 1. Vetëm 6.67% kanë mbajtë mësim edhe nga distanca. Që do të thotë se ata ishin të papërgatitur për mbajtjen e mësimit nga distanca-online.

Grafikoni 1. Përdorimi i teknologjisë informative para Covid-19




2) Si e keni realizuar orën mësimore para pandemisë Covid-19?

Tabela 4. Realizimi i orës mësimore para pandemisë

a)	Në mënyrë frontale	2	13.33%
b)	Sipas trajnimeve	4	26.67%
c)	Të kombinuar	8	53.33%
ç)	Nëpërmjet teknologjisë informative	1	06.67%

Në bazë të përgjigjeve në këtë pyetje, tabela 4 dhe grafikoni 2, del se shumica e mësimitdhënësve, 53.33% orën mësimore me nxënës para shfaqjes së pandemisë Covid-19, e kanë mbajtur në formë të kombinuar. Ndërsa vetëm 6.67%, orën mësimore e kanë realizuar nëpërmjet teknologjisë informative. Orën mësimore në mënyrë frontale e kanë mbajtur 13.33%, ndërsa sipas trajnimeve 26.67%.

Grafikoni 2. Realizimi i orës mësimore para Covid-19



3) Cili është niveli i shqetësimit tuaj gjatë kohës së pandemisë Covid-19, kur mësimin nuk e mbani me nxënës në shkollë?

Tabela 5. Niveli i shqetësimit të mësimitdhënësve

a)	Shqetësim për arritjen e rezultateve	2	13.33%
b)	Pasiguri	4	26.67%
c)	Konfuzion për vlerësimin e nxënësve	2	13.33%
ç)	Mbingarkesë dhe orar i stërgjatur	7	46.67%

Bazuar në përgjigjet, tabela 5 dhe grafikoni 3, shohim se gati gjysma e mësimitdhënësve, përkatësisht 46.67%, konsiderojnë se kishin mbingarkesë gjatë mësimin online dhe orari i tyre ishte i stërngarkuar ngase komunikimi me nxënës dhe prindër merrte kohë dhe ai vazhonte edhe në orët e vona të mbrëmjes. Më shumë se 1/4 e

mësimdhënësve, konkretisht 26.67%, ndienin pasiguri në mbajtjen e mësimit nga distanca dhe nuk ishin të sigurtë se sa do të arrinin të përmbushin objektivat dhe qëllimet e njësive mësimore që po i realizonin. Ndërsa, 13.33% ishin konfuz në vlerësimin e nxënësve dhe po aq (13.33%) kishin shqetësim për arritjen e rezultateve të të nxënësve nga distanca.

Grafikoni 3. Niveli i shqetësimit gjatë kohës së mësimit nga distanca



4) Cilat janë mënyrat e:

4.1. mbajtjes së mësimit nga distanca?

4.2. vlerësimin të nxënësve nga distanca?

Tabela 6. Mënyrat e mbajtjes së orës mësimore dhe vlerësimi i nxënësve

4.1. a)	Nëpërmjet Platformës Zoom, google meet	10	66.67%		
4.1. b)	Ua përcjell detyrat në email	1	06.67%		
4.1. c)	Nëpërmjet Viber, WatsAp	3	20.00%		
4.1. ç)	Nëpërmjet prindërve me Viber, WatsAp	1	06.67%		
4.2. a)	Vlerësimi i detyrave përmes Viber			5	33.33%
4.2. b)	Vlerësimi i detyrave të shtëpisë me email			3	20.00%
4.2. c)	Me anë të dosjes që e përgatitin nxënësit			2	13.33%
4.2. ç)	Vlerësimi i hapur gjatë takimit në Zoom			5	33.33%

Gjatë kohës së pandemisë mësimdhënësit kanë mbajtur komunikimin me nxënës në forma dhe mënyra të ndryshme. Kryesisht kanë përdorur rrjetet sociale si Zoom, google meet 66.67%, duke komunikuar me email 6.67%, nëpërmjet Viber, WatsAp 20.00% dhe duke kontaktuar me prindër ku kanë përdorur Viber, WatsAp e tyre 6.67%. (tabela 6 dhe grafikoni 4.1.)


Grafikoni 4. 1. Mënyrat e mbajtjes së mësimit nga distanca



Mësimdhënësit gjatë kohës së pandemisë, atëherë kur mësimin e zhvillonin nga distanca ishin të obliguar që edhe vlerësimin e nxënësve ta bënin në forma dhe mënyra të ndryshme. Nga tabela 6 dhe grafikoni 4.2. shihet se 1/3, përkatësisht 33.33% e tyre vlerësimin e bënin duke i kontrolluar detyrat e dhëna pas njësive mësimore në

televizionin publik RTK, duke i kërkuar që ato t'ua përcillnin nëpërmjet Viber. Meqë disa mësime të ndryshme takimet online me nxënës i realizonin nëpërmjet zoom-it, ata vlerësimin e nxënësve e bënin edhe në mënyrë të hapur në takimet e tyre në fillim apo në fund të orës mësimore. Në këtë formë 33.33% e mësimeve të bënin vlerësimin e nxënësve. Ndërsa pjesa e mbetur e mësimeve, 33.33% vlerësimin e bënin duke kërkuar që nxënësit të bënin dosjen e tyre me punën e bërë në shtëpi dhe ato pastaj t'i përcillnin nëpërmjet email-it të tyre apo të prindërve të mësimeve.

Grafikoni 4.2. Vlerësimi i nxënësve




5. Si e vlerësoni realizimin e mësimit në distancë nga MASH?

Tabela 7. Vlerësimi i realizimit të mësimit online

a)	Nivel i ultë i përgatitjes së njësive mësimore	6	13.33%
b)	Njësitë në TV nuk përputhen me planprogramin mësimor	3	20.00%
c)	Konfuzion i shtuar për arritjen e objektivave dhe rezultateve	2	13.33%
ç)	Mbingarkesë dhe vështirësi për nxënës	4	26.67%

Grafikoni 5. Vlerësimi i realizimit të mësimit në distancë nga MASH



Në pyetjen se si e vlerësoni realizimin e mësimit në distancë të realizuar nga MASH, nëpërmjet video incizimeve të shfaqura në RTK, të paraqitura në tabelën 7 dhe grafikonin 5, 13.33% e mësimeve konkludojnë se ishte nivel i ultë i përgatitjes së orëve mësimore, përderisa 1/5 apo 20.00% e mësimeve konstatuan se ato njësi të shfaqura nuk përputhen me planprogramin mësimor. Përderisa 40.00% e mësimeve janë konfuz për arritjen e objektivave dhe rezultateve që po shkakton mbingarkesë dhe vështirësi për nxënës.


6. Cili është qëndrimi juaj ndaj mësimit në distancë?

Mësimeve të ndryshme kanë shprehur qëndrimin e tyre për mësimin në distancë gjatë kohës kur nxënësit nuk kanë vijuar mësimet në shkollë gjatë kohës së pandemisë. Ata vlerësojnë se mësimi online është një përparësi dhe në të ardhmen preferojnë që të aplikohet herë pas here. Gjatë kësaj kohe ky lloj mësimi ka pas efekt pozitiv për nxënës të cilët kanë qenë të ngujuar në shtëpi si pasojë e Covid-19. Ata në kohë reale kanë përcjell njësitë e tyre mësimore edhe pse nga distanca, ku ka munguar motivimi dhe jeta sociale.

Tabela 8. Qëndrimi ndaj mësimit në distancë

a)	Ndihmon nxënësit në shtëpi për mësimmnxënie	9	60.00%
b)	Fleksibil-orarin e mësimit e përcaktojnë vetë nxënësit	3	20.00%
c)	Mësimi online ju ndihmon nxënësve në hulumtime edhe nga shtëpia	1	06.67%
ç)	Mësimi online i padobishëm për fëmijët me nevoja të veçanta	2	13.33%

Grafikoni 6. Qëndrimi i mësimmndhënësve ndaj mësimit në distancë



Se mësimi në distancë ju ndihmon nxënësve në mësimmnxënie, janë prononcuar 60.00% e mësimmndhënësve. Bazuar në të dhënat e paraqitur në tabelën 8 dhe grafikoni 6, del se mësimmndhënësit e shohin përparësi të nxënësve nga distanca sa i përket orarit të nxënësve kur mund të marrin mësimet e tyre. Për këtë kanë ndarë mendjen 20.00% e mësimmndhënësve në këtë hulumtim. Ata poashtu kanë shpreh mendimin e tyre edhe për shtresën e pandashme të shoqërisë sonë, fëmijët me nevoja të veçanta, ku vetëm 13.33% mendojnë se mësimi në distancë është i padobishëm për fëmijët me nevoja të veçanta.

7. Cilat shqetësime i keni hasur te nxënësit gjatë kohës së mësimit nga distanca?

Ndërprejra e mësimit për shkak të pandemisë Covid-19, ka sfiduar mësimmndhënësit, prindërit dhe nxënësit. Gjatë kësaj kohe, mësimmndhënësit kanë kontaktuar me nxënësit e tyre në forma të ndryshme, gjithnjë nga distanca. Ata kanë hasur në shumë shqetësime të nxënësve të tyre gjatë periudhës së qëndrimit në shtëpi. Një numër i nxënësve kanë qenë të frikësuar, të stresuar, në panik se si do t'ia dalin me mësimet të cilat nuk i ndëgjojnë direkt në klasë nga mësimmndhënësit e tyre. Poashtu është rritur pasiviteti i tyre, për shkak të mos arritjes në mësimmnxënies nga shtëpia. Të gjitha këto janë përmbledhur në tabelën 9 dhe grafikoni 7.

Tabela 9. Shqetësimet e nxënësve në kohë pandemie

a)	Nxënësit janë në panik se si do të dilet nga kjo pandemi	6	40.00%
b)	Të frikësuar për arritjen e suksesit që ata e pretendojnë	5	33.33%
c)	Ndihen pasiv si mungesë e mos mbajtjes së mësimit në shkollë	1	06.67%
ç)	Konsiderojnë se kjo mënyrë e të nxënësve është përparësi për mësimet	3	20.00%

Se nxënësit janë në panik për mënyrën e daljes nga pandemia janë shprehur 60.00% e mësimmndhënësve bazuar në komunikimet me nxënësit e tyre, nëpërmjet rrjeteve të ndryshme të internetit. Poashtu mësimmndhënësit kanë vërejtur frikë te nxënësit e tyre se sa do t'ia dalin që në këtë formë të të nxënësve do të rrisin suksesin e tyre në fund të periudhave mësimore. Për këtë 1/3 e mësimmndhënësve kanë hasur frikën te nxënësit e tyre. Ndërkaq 1/5 e mësimmndhënësve apo 20.00%, konsiderojnë se nxënësit e tyre e shohin këtë formë të të nxënësve si përparësi për ta. Mirëpo pasiviteti i nxënësve është në rritje, si pasojë e të mësuarit nga distanca, janë shprehur 6.67%. Këtë e kanë vërejtur gjatë angazhimit të tyre në mësimet online, përcjelljen e detyrave të shtëpisë, motivimi i ultë për gërmime të reja në shkencat e natyrës, etj.

Grafikoni 7. Shqetësimet e nxënësve gjatë mbajtjes së mësimit nga distanca



8. Sa janë të pajisur nxënësit e juaj me teknologji informative për të ndjekur mësimin nga distanca?
Për të përcjell mësimit nga distanca, nxënësve u është nevojë të kenë smart pajisje teknologjike. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë qenë të pajisur me këto pajisje edhe para pandemisë, ku falë zhvillimit të hovshëm të teknologjisë informative është mundësuar edhe çmimi i përshtatshëm për popullatën e shtresës së mesme. Megjithatë një numër i nxënësve kanë pasur mungesë të internetit apo edhe të smart pajisjeve të cilat mundësojnë ndjekjen e mësimit nga distanca gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Se sa janë pajisur nxënësit me teknologji informative, për të ndjekur mësimit nga distanca, shihet në tabelën 10 dhe grafikonin 8, si në vijim.

Tabela 10. Pajisja e nxënësve me TI

a)	Nxënësit janë të pajisur me smart pajisje të TI	6	40.00%
b)	Nuk janë të pajisur me smart pajisje të TI	3	20.00%
c)	Arrijnë me lehtësi të ndjekin mësimit nga distanca	4	26.67%
ç)	Janë ndihmuar me smart pajisje në forma të ndryshme	2	13.33%

Grafikoni 8. Pajisja e nxënësve me smart teknologji informative



Rreth 40.00% të mësimeve kanë konstatuar se nxënësit e tyre janë pajisur me smart pajisje para pandemisë, ndaj me lehtësi kanë përcjell mësimit nga distanca. Por një numër i nxënësve për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, nuk kanë arrit që të kenë çasje në internet, smart telefona apo pajisje tjera relevante për ndjekje të mësimeve nga distanca. Këtë mungesë të nxënësit e kanë hasur 20.00% e mësimeve, ndaj edhe kanë raportuar te organet e tyre. Pas angazhimeve të faktorëve të ndryshëm, 13.33% e mësimeve raportojnë se nxënësit e tyre kanë dalë të furnizohen me pajisje të TI, që ua kanë mundësuar të nxënësit nga shtëpia.

6. DISKUTIM

Të gjeturat nga ky hulumtim konfirmojnë se mbyllja e nxënësve dhe mësimdhënësve në shtëpi, si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid-19, ishte e rëndë dhe e pa imagjinuar. Ndërprerja e menjëhershme e procesit edukativo-arsimor, në Kosovë dhe pothuaj në mbarë botën, shkaktoi një frigë, panik, pasiguri, pasivitet dhe jo produktivitet të nxënësve. Mësimdhënësit ishin të papërgatitur për këtë sfidë, për çka edhe u deklaruan se para pandemisë pak kishin përdor teknologjitë informative dhe platformat për mësimnxënie nga distanca. Teknologjitë informative i kishin përdor pothuajse vetëm për të përgatit plan-programe, teste për nxënës dhe ndonjë prezantim me projektor para nxënësve në klasë. Para pandemisë orët mësimore i mbanin sipas reformave të reja me Kurrikulë të Arsimit të Republikës së Kosovës. Por edhe në mënyra tjera sipas nevojës për të kuptuar nxënësit më mirë njësitë e tyre mësimore. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndërprerje të plotë të mësimin, shqetësimi i mësimdhënësve u rrit në maksimum. Tani ishte i pranishëm shqetësimi se si do t'i vlerësonin nxënësit, madje edhe se si do t'i përcillnin mësimet e tyre te ta. Koha që do të kalonin për kontakte me nxënës dhe prindër, lidhur me vijueshmërinë e të nxënës bërë që orari i tyre të stërgjatej. Me nguti, për shkak të mbylljes së shkollave, fillon edhe transmetimi i video incizimeve në RTK, të cilat përgatiten nga një grup mësimdhënësish të cilët ishin të papërvogë në këtë drejtim. Mbi bazën e kësaj ata filluan edhe konsultimet me nxënës nëpërmjet rrjeteve e platformave të ndryshme. Poashtu edhe detyrat e shtëpisë me mund arrinin t'i kontrollonin, e këtë e bënin me Zoom, Viber, WhatsApp, email, e forma e mënyra tjera, gjithnjë përmes interneti. Qëndrimi i mësimdhënësve për mësimin nga distanca në të ardhmen sugjerojnë se do të jetë ndihmesë për nxënës dhe mësimdhënës. Ata e shohin këtë mënyrë të të nxënës nga distanca si epërsi dhe ja vlen të punohet më shumë në këtë drejtim duke ju sugjeruar politkbërësve, ekspertëve arsimor, qeverive lokale dhe qendrore, prindërve, mësimdhënësve dhe të gjithë akterëve tjerë të lidhur me fushën e arsimit që të bëjnë më shumë për mësimin elektronik.

Gjatë kohës së qëndrimit të nxënësve në shtëpi, si pasojë e Covid-19, mësimdhënësit e intervistuar kishin vërejtur se nxënësit e tyre po kalonin ditë jo të lehta ku edhe kishin frikë, pasiguri, depresion, pasivitet në nxënie të njohurive të reja të shkëputura përnjëherë. Të gjitha këto, deklarohen mësimdhënësit e përfshirë në këtë ulumtim, i kishin hetuar gjatë kontakteve me nxënësit e tyre nga distanca. Gjithashtu disa nga prindërit nuk kishin arrit që t'ju siguronin fëmijëve të tyre internetin, pajisjet e mençura elektronike, laptop, ip-edë, para pandemisë për shkak të kushteve jo të mira ekonomike. Kjo edhe më shumë po e rëndonte situatën aktuale të krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19.

Për fund vlenë të theksohet se me gjithë vështirësitë e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve konkludohet se është arrit që një pjesë e boshllëkut të krijuar nga mos vijimi i mësimin në shkolla të ketë pasur një sukses sado të vogël.

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Të nxënës nga distanca si pasojë e pandemisë Covid-19, që u paraqit në vitin 2019, e që po vazhdon edhe më tutje në vitin 2020, ishte sfidë e mësimdhënësve të mbarë botës dhe poashtu edhe të Kosovës. Mbyllja pa asnjë planifikim i zuri pothuajse të papërgatitur mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Dëshprimi ishte tejet i madh nga të gjithë dhe shqetësimi po rritej se si do të bëhej tani organizimi i të nxënës nga distanca. Numër i madh i mësimdhënësve qenë të papërgatitur për këtë metodë të të nxënës. Me një intensitet të shtuar fillojnë organizimet e para të kontakteve mësimdhënës, prindër, nxënës. Televizioni publik RTK fillon transmetimin e video incizimeve të përgatitura nga një grup mësimdhënësish të cilët ndoshta edhe për të parën herë përballëshin me kamerat televizive. Te nxënësit fillon të paraqitet frika, pasiguria, pasivitetin në mësimnxënie me këtë formë të të nxënës, të panjohur për ta. Një numër i tyre nuk kishin as internet e smart pajisje për të përcjellë mësimin nga distanca si pasojë e pandemisë Covid-19. Megjithatë mësimdhënësit e përfshirë në këtë hulumtim deklarohen se kjo mënyrë e të nxënës është një epërsi dhe ja vlenë që të punohet në këtë drejtim për të përçarur njohuritë e tyre te brezi i ri.

Mbi bazën e kësaj ipen edhe disa rekomandime që do të ishin në të mirën e vendimmarrjeve të qeverive të ardhshme, për të zhvilluar këtë formë të të nxënës. Ndër të tjera, hulumtimi rekomandon:

- Institucionet arsimore të formojnë ekipe ekspertësh të fushës së mësimnxënies nga distanca: e-learning.
- Të mbahen trajnime për mësimdhënës, sidomos të gjeneratave më të reja, për mësimdhënie nëpërmjet internetit.
- Shkollat të pajisen me teknologji informative duke ju krijuar kushte mësimdhënësve që të kenë qasje në kohë reale me nxënësit e tyre.
- Mësimdhënësit që janë më afër pensionimit të mbështeten nga mësimdhënësit e papunësuar, me angazhimin e tyre për të ofruar mësim nga distanca. Kjo të bëhet me vendime dhe kontrata të veçanta të cilat edhe parashihen me ligje në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Qeveria të rrit buxhetin për këtë fushë kryesore, të nxënës nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja informative, e cila konsiderohet, nga ky hulumtim, si epërsi.
- Të mbështeten prindërit me kushte jo të mira ekonomike në forma të ndryshme, për t'ju siguruar fëmijëve të tyre mundësinë e qasjes në kohë reale të mësimnxënies nga shtëpia.

- Shkollat të formojnë Platforma unike të mësimit nga distanca, për nxënësit dhe mësimsdhënësit e tyre.
- Të formohen rrjete elektronike të shkollave në nivel komune, ku nxënësit të kenë mundësi që të zgjedhin për mësimsdhënë të fushave të ndryshme me zgjedhje.
- Prindërit të rrisin konsideratën ndaj mësimsdhënësve që gjithnjë bëjnë të pamundurën për nxënësit e tyre.
- Të rritet bashkëpunimi në trekëndshin: prindër-nxënës-mësimsdhënë.

LITERATURA

- Aldahdouh, T. Z., Nokelainen, P., & Korhonen, V. (2020). Technology and Social Media Usage in Higher Education: The Influence of Individual Innovativeness. *SAGE Open*, 10(1), 2158244019899441.
- Almutairi, A. (2009). *Teachers' perceptions of technology and technology education, years 7 to 10* (Doctoral dissertation, Auckland University of Technology).
- ASK (2017). Kosovo Education Statistics for 2016-2017. Education Information Management System. Kosovo. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/3439/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-shqip.pdf>
- ASK (2019). Kosovo Education Statistics for 2018-2019. Education Information Management System. Kosovo. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/5055/statistikat-e-arsimit-2018-2019.pdf>
- Collis, B. (1998). New didactics for university instruction: why and how?. *Computers & Education*, 31(4), 373-393.
- Cope, C., & Ward, P. (2002). Integrating learning technology into classrooms: The importance of teachers' perceptions. *Journal of Educational Technology & Society*, 5(1), 67-74.
- Gjoshi, R., & Kume, K. (2014). Research on the administrator professional training and its role in the implementation of educational institutions reforms in Kosovo. *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, 1, 26-30
- Lurvnik: UNESCO. (2020, March 30). COVID-19 Webinar: A new world for teachers, education's frontline workers. Marrë nga <https://en.unesco.org/news/covid-19-webinar-new-world-teachers-educations-frontline-workers>
- Mashti (2020). Ministry of Education Science Technology and Innovation informations regarding e-learning. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>
- Mashti (2020c). Statistical Notes. Data on pre-university education. Education Information Management System. Kosovo. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/02/shenime-statistikore-2019-2020-arsimi-parauniversitar-2.pdf>
- Masht, (2015). Evaluation Report. Kosovo Education Strategic Plan, 2011-2016. Ministry of Education Science and Technology, MEST. Kosovo. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf>
- Masht, (2016). Kosovo Education Strategic Plan 2017-2021. Ministry of Education, Science and Technology, MEST. Kosovo. Marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/KOSOVO_EDUCATION_STRATEGIC_PLAN.pdf
- Masht, (2020b). Duties and responsibilities for the implementation of distance learning. Available at: Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/lib04-udhezuesi-per-mesimdhenes-finali.pdf>.
- Mexhuani, A. (2015). Integration of information and communication technology in teaching and learning. Kosovo Pedagogical Institute, IPK. Prishtinë. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/a-mexhuani-integrimi-i-tik-ut-ne-mesimdhene-dhe-nxenie-1.pdf>
- Mishra, P., & Koehler, M. J. (2006). Technological pedagogical content knowledge: A framework for teacher knowledge. *Teachers college record*, 108(6), 1017-1054.
- NCIRD, (2020). Coronavirus Disease 2019. National Center for Immunization and Respiratory Diseases (NCIRD). Division of Virtul Diseases. Marrë nga: <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/daily-life-coping/managing-stress-anxiety.html>
- Shulman, L. S. (1986). Those who understand: Knowledge growth in teaching. *Educational researcher*, 15(2), 4-14.
- STIKK (2013). Internet penetration and use in Kosovo. Association for Information and Communication Technology of Kosovo, STIKK. Kosovë. Marrë nga: https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/11/Publications_2013_-_Internet_Penetration_SQ.pdf
- UNESCO (2020). Covid-19 Impact on Education Data. COVID-19 Education Disruption and Response. The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, UNESCO. Paris, France.
- UNESCO. (2020, March 30). COVID-19 Webinar: A new world for teachers, education's frontline workers. Marrë nga <https://en.unesco.org/news/covid-19-webinar-new-world-teachers-educations-frontline-workers>
- Yokozeki: UNESCO. (2020, March 30). COVID-19 Webinar: A new world for teachers, education's frontline workers. Marrë nga <https://en.unesco.org/news/covid-19-webinar-new-world-teachers-educations-frontline-workers>